Kontrolli i Lartë i Shtetit



# HARTA E PROCESEVE

## SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT

2025

PËRGATITI:

**DEPARTAMENTI I METODOLOGJISË, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL**

# HARTA E PROCESEVE

# SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË

| KOMPONENTI SOAQM | AFATI | DREJTON PROCESIN | PRODUKT |
|---|---|---|---|
| 1. Nis Procesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë.<br><br>*(detajuar në tabelën nr. 1.1 sipas Aneksit 1 bashkëlidhur)* | Janar të çdo viti<br><br>Korrik të çdo viti | Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional harton urdhrin për fillimin e procesit të menaxhimit të riskut të cilësisë; shpërndan regjistrin tek GMS për vlerësim; konsolidon regjistrin pas komenteve të GMS – së.<br><br>GMS kryen procesin. | Regjistri i riskut të cilësisë i përditësuar. |
| **2.** Nis Procesi i Monitorimit dhe Përmirësimit:<br><br>- Në nivel organizativ.<br><br>*(detajuar në tabelën nr. 2.1 sipas Aneksit 2 bashkëlidhur)* | Tetor të cdo viti | Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional përgatit urdhrin për fillimin e procesit të monitorimit në nivel organizativ.<br><br>Grupi i punës kryen monitorimin në nivel organizativ. | Plani i monitorimit në nivel organizativ përgatitur nga grupi i punës<br><br>Raporti i monitorimit në nivel organizativ, në zbatim të planit, përgatitur nga grupi i punës. |
| **3.** Nis Procesi i Monitorimit dhe Përmirësimit:<br><br>**-** Në nivel auditimi.<br><br>*(detajuar në tabelën nr. 2.1 sipas Aneksit 2 bashkëlidhur)* | Tetor të cdo viti | Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional përgatit urdhrin për fillimin e procesit të monitorimit në nivel auditimi.<br><br>Grupi i punës për monitorimin kryen monitorimin në nivel auditimi. | Planin i monitorimit në nivel auditimi përgatitur nga grupi i punës.<br><br>Raporti i monitorimit në nivel auditimi, në zbatim të planit, përgatitur nga grupi i punës. |
| **4.** Rishikimi i vazhdueshëm i cilësisë së auditimeve (EQR). | Për çdo auditim sipas Rregullores së Procedurave të Auditimit | Departamenti i Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve. | Mendimet për çdo auditim sipas Rregullores së Procedurave të Auditimit. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **5.** Vlerësimi dhe Konkluzioni mbi efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në KLSH.<br><br>*(detajuar në tabelën nr. 3.1 sipas Aneksit 3 bashkëlidhur)* | Janar – Shkurt i vitit pas ardhës, për vitin para rendës | Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional harton urdhrin për nisjen e procesit të vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë në KLSH. | 1. Raporti përkatës ku konsolidohen gjetjet që përbëjnë mangësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë në KLSH përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional:<br>2. Kryetari miraton vlerësimin. |
| **6.** Vlerësimi dhe Konkluzioni mbi efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në KLSH bëhen pjesë e Raportit të Performancës së KLSH – së. | Mars të cdo viti | Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional | Përgatitet informacioni përmbledhës për raportin vjetor të performancës së KLSH - së. |

## ANEKSI 1:  PROCESI I MENAXHIMIT TË RISKUT TË CILËSISË

**Tabela 1.1**

| Dokumentet standarde | Baza Ligjore/Nën Ligjore | Përgjegjësitë | Kërkesat | Afati |
|---|---|---|---|---|
| 1. Politika e Menaxhimit të Cilësisë https://www.klsh.org.al/ëp-content/uploads/2025/02/Politika-e-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Cilesise-SoAQM-1-1.pdf<br>2. Udhëzuesi për Menaxhimin e Riskut të Cilësisë https://www.klsh.org.al/ëp-content/uploads/2025/02/Menaxhimi-i-Riskut-te-Cilesise-udhezues.pdf | - Ligji nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,<br><br>- ISSAI 140 Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit<br><br>- Udhëzuesi për Menaxhimin e Riskut të Cilësisë | GMS:<br>- Kupton dhe zbaton standardet dhe parimet e ISSAI 140, duke përfshirë udhëzuesin e implementimit dhe letrat e punës Harton objektivat e cilësisë<br>- Merr pjesë vazhdimisht në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të cilësisë në KLSH<br>- Harton përgjigjet për të adresuar risqet e cilësisë të identifikuara<br>- Monitoron vazhdimisht implementimin e përgjigjeve. | GMS drejtohet nga Kryetari i KLSH Anëtarët e GMS janë pjesë e drejtuesve të lartë të KLSH-së, drejtorë departamentesh. | Janar, Korrik të çdo viti. |

## ANEKSI 2:  PROCESI I MONITORIMIT DHE PËRMIRËSIMIT

### Tabela 2.1

| Dokumentet standarde | Baza Ligjore/Nën Ligjore | Përgjegjësitë | Kërkesat | Afati |
|---|---|---|---|---|
| 1. Politika e Menaxhimit të Cilësisë https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/02/Politika-e-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Cilesise-SoAQM-1-1.pdf<br>2. Udhëzuesi për Monitorimin dhe Përmirësimin | - Ligji nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,<br><br>- ISSAI 140 Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit<br><br>- Udhëzuesi për Monitorimin dhe Përmirësimin | Grup i punës:<br>- Kupton dhe zbaton standardet dhe parimet e ISSAI 140, duke përfshirë udhëzuesin e implementimit dhe letrat e punës; si dhe politikat, procedurat dhe direktivat e KLSH - së që lidhen me sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit dhe politikat që lidhen me monitorimin;<br>- Përgatit planin vjetor të monitorimit; Përcakton fushën e përgjithshme të monitorimit duke përdorur kriteret e kësaj politike;<br>- Kryen monitorimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit në nivel organizativ, dhe në nivel auditimi;<br>- Identifikon mangësitë në sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit dhe ofron veprime korrigjuese, sipas rastit<br>- Kur është e përshtatshme, ndihmon në vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit bazuar në vlerësimet | Grupi i Punës ad hoc:<br>Grupi i monitorimit do të drejtohet nga një zyrtar i lartë me të paktën dhjetë (10) vjet eksperiencë në auditim dhe me përfshirje të konsiderueshme në menaxhimin e cilësisë në KLSH.<br>Personi/grupi i personave i përfshirë në procesin e monitorimit dhe përmirësimit, duhet të ketë:<br>- njohuri të thelluara mbi standardet e menaxhimit të cilësisë dhe kriteret e monitorimit;<br>- aftësi shumë të mira analitike, komunikuese; dhe pune në grup;<br>- të paktën 5-7 vite eksperiencë pune në KLSH;<br>- të jetë të paktën auditues i parë.<br>Anëtarët e grupit të monitorimit duhet të kenë autorizimin e duhur nga Kryetari i KLSH-së për kryerjen e veprimtarive të monitorimit. | Janar, Korrik të çdo viti. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | në niveli organizativ dhe nivel auditimi;<br>- Raporton rezultatet e monitorimit drejtpërdrejtë të Kryetari i KLSH-së<br>- Ruan pavarësinë nga menaxhimi i KLSH-së, subjekti i audituar, grupi i auditimit dhe rishikuesi i cilësisë së auditimit (EQR) - Zhvillon trajnime rreth funksionit të monitorimit për personelin e përzgjedhur të KLSH-së dhe krijon ndërgjegjësim<br>- Jep rekomandime për ndryshimin e politikës së monitorimit kur është e nevojshme. | | |

## ANEKSI 3: VLERËSIMI DHE KONKLUZIONI MBI SISTEMIN E MENAXHIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT

### Tabela 3.1

| Dokumentet standarde | Baza Ligjore/Nën Ligjore | Përgjegjësitë | Kërkesat | Afati |
|---|---|---|---|---|
| 1. Politika e Menaxhimit të Cilësisë https://WWW.klsh.org.al/Wp-content/uploads/2025/02/Politika-e-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Cilesise-SoAQM-1-1.pdf<br>2. Udhëzuesi për Vlerësimin e Sistemit | - Ligji nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,<br><br>- ISSAI 140 Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit<br><br>- Udhëzuesi për Vlerësimin e Sistemit | Kryetari i KLSH-së, ka përgjegjësinë përfundimtare për SOAQM.<br>Për kryerjen e vlerësimit duhen marrë në konsideratë rezultatet e monitorimit dhe çdo vlerësim të bërë nga SAI Në proces do të përfshihet vlerësimi në nivel individual dhe në nivel të përgjithshëm i mangësive të konstatuara si dhe nëse janë korrigjuar këto mangësi të konstatuara Kryetari i KLSH-së do të nxjerrë një përfundim mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SoAQM) të KLSH-së, duke marrë parasysh rezultatet e procesit të vlerësimit. | Kryetari i KLSH- cakton Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional për të mbledhur informacionin e nevojshëm për të kryer Vlerësimin e SoAQM.<br>Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional përzgjedh punonjësit e departamentit për kryerjen e kësaj detyre sipas kritereve në vijim:<br>- të kenë njohuri të mjaftueshme mbi ISSAI 140 dhe mbi aplikimin e tij, si dhe informacion të nevojshëm mbi SoAQM;<br>- të jenë trajnuar për kryerjen e kësaj detyre;<br>-të kenë të paktën 5 vite eksperiencë pune në KLSH ;<br>- të jenë të paktën auditues të lartë dhe të ketë akses për të mbledhur të gjithë dokumentacionin/informacionin që është i nevojshëm për këtë qëllim. | Janar – Shkurt |